



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

### VENDIM

Nr. 55, datë 19.04.2019

#### PËR

#### **NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 43, DATË 12.03.2019, “PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË KANDIDATËVE PËR KËSHILLTARË DHE NDIHMËS LIGJORË QË PLOTËSOJNË KRITERET PËR TË MARRË PJESË NË PROVIMIN E PRANIMIT NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 34, 53, 55 dhe 56 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 274 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në vendimet nr.17, 18 dhe 19, datë 29.01.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe në propozimin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriteve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë që do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020,

#### V E N D O S I :

1. Në vendimin nr.43, datë 12.03.2019 “Për miratimin e listës emërore të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020”, bëhet shtesa e mëposhtme:

1.1 Në listën emërore të kandidatëve për Këshilltarë Ligjorë, që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020, në lidhjen 3, bashkëlidhur Vendimit nr. 43, datë 12.03.2019, “Për miratimin e listës emërore të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë shkollës së magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020”, pas pikës 16, shtohet pika “17”:

17. Alfred Bib Gjonpali.

2. Një kopje e vendimit t'i njoftohet Shkollës së Magjistraturës dhe z. Alfred Bib Gjonpali.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**